**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
***Qeveria - Vlada - Government***
***Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister***

---

Nr. 040 /2020
Datë: 17.06.2020

Kryeministri i Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 94 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 6 (2.1) dhe nenin 11 (1) të Rregullores Nr. 06/2020 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nxjerr:

## V E N D I M

1. Z. Florian Dushi emërohet Zëvendësminister në Ministrinë e Drejtësisë.

2. Zëvendësministri emërohet për mbështetjen e Ministrit të Ministrisë së Drejtësisë dhe është përgjegjës për menaxhimin e aktiviteteve në fushat e përcaktuara nga Ministri, si dhe për zëvendësimin e Ministrit kur ai mungon ose kur nuk është në gjendje të kryejë detyrën e tij.

3. Zëvendësministri, brenda tridhjetë (30) dite nga hyrja në fuqi e këtij Vendimi është i obliguar të bëjë deklarimin e pasurisë, në pajtim me Ligjin Nr. 04/L-050 për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publik dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtar, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-228 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-050.

4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryeministri.

**Avdullah HOTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

*Vendimi i dërgohet:*

- *Z. Florian Dushi, Zëvendësminister në Ministrinë e Drejtësisë;*
- *Të gjithë Zëvendëskryeministrave;*
- *Të gjithë Ministrave;*
- *Shefit të stafit të Kryeministrit;*
- *Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së;*
- *Arkivit të Qeverisë.*